

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës :

Specialist i Administrimit të Planit të Numeracionit–AKEP

Procedura : **PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINE EKZEKUTIVE**

Në zbatim të Kreu IV të Ligjit nr. 152/2013 "Për nepunesin civil", i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 243, date 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, levizjen paralele, periudhen e proves dhe emerimin në kategorinë ekzekutive", Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) njofton se :

- **Z. Endri Nela**
- **Z.Gersi Spaho**

do të vazhdojnë konkurimin në procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

1. **Konkurimi**

- **Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **18.10.2018 ora 10:00**.
- **Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **18.10.2018 ora 12:00**.

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv në AKEP- KPP**, nëpërmjet vleresimit të jetëshkrimit, vleresimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidateve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15 pikë**;
- b) për intervisten e strukturuar me goje, deri në **25 pikë**;

c) për vlerësimin me shkrim, deri në **60 pike**;

Pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim, nëse kandidati grumbullon më shumë se (mbi 30 pikë e lart), nga vlerësimi me shkrim ai i kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë dhe vlerësimin e jetëshkrimit.

Komiteti, në përfundim të vlerësimit, për zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **“Specialist i Administrimit të Planit të Numeracionit”**.

Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, Kreu IV të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për pranimin, levizjen paralele, periudhen e provës dhe emerimin në kategorinë ekzekutive".

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **19.10.2018**.

Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **22.10.2018**.

Njesia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)